



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 680/3 Prot.

Vlorë më, 11.03 2026

VENDIM

Nr. 14 datë 11.03.2026

PËR

MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN E PROJEKTEVE TË KËRKIM-ZHVILLIMIT TË FINANCUARA NGA BUXHETI I UNINIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja d dhe të nenit 49, pika 1, shkronja e, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të nenit 19, pika 1, gërma "dh" dhe të nenit 25, pika 1, shkronja "e", të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, si dhe duke iu referuar relacionit juridik nr. 2184, prot., datë 15.09.2025, përcjellë nga Sektori Juridik, Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 22.09.2025,

VENDOSI:

1. Të miratohen ndryshimet në Rregulloren për Projektet e Kërkim-Zhvillimit të financuara nga buxheti i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, sipas materialit bashkëlidhur, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Zëvendësrektorit për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor dhe Drejtorja e Kërkimit, Zhvillimit dhe Marrëdhënieve me të Tretët.
3. Ky vendim u përcillet për njoftim Administratorit të UV-së, Drejtorisë së Kërkimit, Zhvillimit dhe Marrëdhënieve me të Tretët, Zëvendësrektorit për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor dhe Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmëse Akademike, për shpallje në faqen web të vendimit dhe për realizimin e njoftimeve përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF. DR. AURELA SALIAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

R R E G U L L O R E
P Ë R
PROJEKTET E KËRKIM-ZHVILLIMIT
TË FINANCUARA NGA BUXHETI I
UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE



Miratuar nga Senati Akademik i UV me Vendim nr. 125, datë 15.12.2025 dhe ndryshuar me
Vendim Senati Akademik nr. 14, datë 11.03.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

Preambul

Në kuadër të zbatimit të objektivave strategjike të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë për forcimin e kërkimit shkencor dhe inovacionit, si dhe në mbështetje të dispozitave të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të Statutit të UV-së dhe të Rregullores së Përgjithshme të Universitetit (Kreu X), Senati Akademik miraton këtë rregullore të standardizuar për **aplikimin, miratimin, implementimin dhe raportimin e projekteve kërkim-zhvillimi, të financuara nga buxheti i UV-së**. Kjo rregullore synon të unifikojë veprimet e të gjitha strukturave të përfshira – nga njësitë bazë e qendrat kërkimore deri te Rektorati dhe Bordi i Administrimit – duke përafruar praktikat institucionale me standardet kombëtare të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), si dhe me parimet e transparencës, integritetit dhe efikasitetit në përdorimin e fondeve publike.

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Kjo rregullore ka për qëllim të rregullojë mënyrën e aplikimit, miratimit, implementimit, monitorimit, dhe raportimit të projekteve kërkimore-zhvillimore (PKZHUV) që financohen nga buxheti i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë (UV). Kjo procedurë rregullon të gjitha fazat, veprimet dhe përgjegjësitë e aktorëve institucionalë në procesin e aplikimit, miratimit, implementimit, monitorimit dhe raportimit të projekteve kërkimore-zhvillimore të financuara nga buxheti i UV.
2. Rregullorja synon të garantojë transparencën, konkurrueshmërinë dhe përdorimin efikas të fondeve publike për kërkimin shkencor.
3. Zbatimi i saj bëhet në përputhje me standardet e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) dhe aktet e brendshme të UV-së.

Neni 2 Baza ligjore

Kjo procedurë mbështetet në:

1. Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor";
2. Statutin e UV-së (Urdhri nr. 287, datë 30.06.2025);
3. Rregulloren e Përgjithshme të UV-së (Vendimi SA nr. 88, datë 22.09.2025);
4. Rregulloren Financiare të UV-së (Vendimi BA nr. 45, datë 05.12.2023);
5. Vendimet e SA dhe BA;
6. Udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe të Ministrisë së Financave;
7. Udhëzimet e AKKSHI-t për formatin e aplikimit dhe raportimit të projekteve kombëtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Projekt kërkim-zhvillimi (PKZH) është një aktivitet i strukturuar kërkimor që synon prodhimin e dijes së re, testimin e hipotezave, zhvillimin e produkteve, proceseve apo shërbimeve innovative për UV-në apo ndaj të tretëve.
2. Kjo rregullore zbatohet për projektet kërkimore-zhvillimore që:
 - a) financohen nga fondet e UV-së;
 - b) realizohen nga stafi akademik në UV;
 - c) synojnë rezultate kërkimore ose zhvillimore.
3. Për projektet me bashkëfinancim ose me të tretë, kjo procedurë zbatohet pjesërisht, sipas marrëveshjeve përkatëse.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

KREU II
ORGANET DHE PËRGJEGJËSITË

Neni 4
Strukturat përgjegjëse

1. Bordi i Administrimit (BA)

- a) Miraton në buxhetin vjetor të UV një zë të veçantë dhe fond në dispozicion për financimin e projekteve kërkimore-zhvillimore (PKZHUV) për çdo departament dhe qendër kërkimore-shkencore në UV, në përputhje me fushat prioritare të miratuara nga Senati Akademik;
- b) Mbikëqyr zbatimin financiar të fondeve PKZHUV përmes raporteve të Administratorit;

2. Senati Akademik (SA)

- a) Miraton çdo fillim viti akademik fushat prioritare për zhvillimin e projekteve kërkimore-zhvillimore, në përputhje me strategjinë institucionale të kërkimit dhe rekomandimet e njësive kryesore;
- b) Propozon BA-së çdo vit fondin total vjetor sipas njësive bazë dhe QKSH-ve për projekte PKZHUV;
- c) Miraton procedurën institucionale për projektet kërkimore-zhvillimore dhe çdo ndryshim të saj.

3. Rektorati

- a) Miraton dhe autorizon publikimin e thirrjes për aplikime për PKZHUV sipas njoftimit për aplikim të përgatitur nga SKSHP;
- b) Miraton përfundimisht listën e projekteve të financuara në bazë të vlerësimeve të Komitetit Shkencor të Fakulteteve (KSHF);
- c) Mbikëqyr zbatimin e përgjithshëm akademik dhe administrativ të projekteve, nëpërmjet strukturave të varësisë si njësi bazë, KSHF dhe SKSHP;
- d) Miraton mbylljen e projektit, pas certifikimit final të raportit përfundimtar prej Rektoratit.

4. Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Projekteve (SKSHP)

- a) Harton dhe përcjell për miratim, paraprakisht tek Zëvendësrektori i Kërkimit Shkencor dhe përfundimisht tek Rektori, thirrjen për aplikim për PKZHUV, në përputhje me fushat prioritare të miratuara nga Senati Akademik dhe fondet e miratuara nga Bordi i Administrimit;
- b) Me miratim të Rektorit publikon thirrjen në faqen zyrtare të UV-së dhe e shpërndan përmes adresave elektronike tek stafi akademik i UV-së;
- c) Koordinon procesin e aplikimit dhe verifikon dosjet e aplikimit për plotësimin formal dhe përputhshmërinë me kriteret administrative.
- d) Përcjell dosjet e rregullta për vlerësim tek Komitetet Shkencore dhe administrojnë vendimarrjen e tyre si pjesë e dosjeve të PKZHUV;
- e) Përgatit listën përfundimtare të projekteve të miratura nga Rektorati
- f) Regjistron të gjitha PKZHUV e miratuar për financim në databazën e projekteve, faqen zyrtare të UV-së dhe administrojnë dosjen elektronike e fizike të tyre.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

- g) Monitoron zbatimin e projekteve vetëm në aspektin teknik dhe afatshkurtër (jo akademik dhe jo financiar), duke siguruar raportimin periodik dhe përfundimtar sipas formateve të miratuara.

5. Komiteti i Etikës në Kërkim (KEK)

- a) Jep Lejet Etike, të cilat firmosen njëkohësisht nga Kryetari i Komitetit të Etikës dhe nga Rektori, për zhvillimin e projekteve të kërkim-zhvillimit

- në popullatën e studentëve dhe personelit të UV,
- brenda infrastrukturës së UV-së

pavarësisht nëse këto PKZH zhvillohen nga personel dhe studentë të UV apo nga persona të tretë jashtë UV-së.

- b) Verifikon ankimimet për integritetin, ligjshmërinë dhe etikën e projekteve dhe punimeve shkencore, të zhvilluara në Universitetin 'Ismail Qemali' ose nga personeli i UV-së.

6. Komiteti Shkencor i Fakulteteve (KSHF)

- a) Shqyrton dosjet e projekt-propozimeve PKZHUV, të përcjella nga SKSHP, dhe vlerëson përmbajtjen shkencore, metodologjinë dhe përputhshmërinë me fushat e studimit të njësishë, sipas skedës së miratuar.
- b) Jep Lejen për Zhvillimin e Projekteve në bazë të një formati të miratuar paraprakisht. Projekt-aplikimet, e miratuara paraprakisht për zhvillim në njësinë kryesore, i përcjell për miratim përfundimtar në rektorat.
- c) Vlerëson raportet shkencore përfundimtare të projekteve dhe përcjell relacionet për përmbylljen e projektit pranë Rektoratit të UV-së.

7. Komiteti Shkencor Institucional (KSHI) *ad hoc*

- a) Shqyrton dosjet e projekt-propozimeve PKZHUV në nivel institucional apo të administruara nga strukturat e Rektoratit, të përcjella nga SKSHP, dhe vlerëson përmbajtjen shkencore, metodologjinë dhe përputhshmërinë me fushat e studimit të njësishë, sipas skedës së miratuar.
- b) Jep Lejen për Zhvillimin e Projekteve në bazë të një formati të miratuar paraprakisht. Projekt-aplikimet, e miratuara paraprakisht për zhvillim, i përcjell për miratim përfundimtar në rektorat.
- c) Shqyrton ankimimet për vendimmarrjen e KSHF apo KSHI e mëparshme. Vendimmarrja e tij është përfundimtare.
- d) Vlerëson raportet shkencore përfundimtare të projekteve dhe përcjell relacionet për përmbylljen e projektit pranë Rektoratit të UV-së.

8. Departamentet dhe Qendrat Kërkimore-Shkencore (QKSH)

- a) Identifikojnë, zhvillojnë dhe propozojnë ide kërkimore në përputhje me objektivat strategjike të universitetit dhe me prioritetet e përcaktuara çdo vit nga Senati Akademik.
- b) Mbështesin personelin akademik dhe studentët në përgatitjen e aplikimeve për projekt-propozime PKZHUV, duke garantuar përputhshmërinë tematike me fushën e studimit dhe me objektivat kërkimore të njësishë/QKSH
- c) Japin miratimin paraprak për zhvillimin e projekt-propozimit;





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

d) Monitorojnë ecurinë e projekteve në nivel akademik, kërkojnë raporte ndërmjetëse kur është e nevojshme.

9. Administratori dhe Sektori Ekonomik

- a) Menaxhojnë disbursimin financiar dhe bilancin përfundimtar të PKZHUV;
- b) Mbështesin drejtuesit e projekteve në plotësimin e raportetve financiare përfundimtare.

10. Drejtuesi i PKZHUV dhe grupet e punës

- a) Personeli akademik i UV-së, ka të drejtë të marr pjesë në thirrjet për projekt-propozime PKZHUV, në përputhje me fushat prioritare të miratuara nga Senati Akademik dhe me kriteret e përcaktuara në udhëzimin e thirrjes.
- b) Drejtuesi i PKZHUV është anëtar i personelit akademik me përgjegjësi për aplikimin, zbatimin dhe raportimin e plotë të projektit, duke siguruar përputhshmërinë me standardet shkencore, etike dhe institucionale të UV-së.
- c) Ai propozon grupin e punës dhe në rast miratimi për financim siguron realizimin e objektivave kërkimore brenda afateve dhe buxhetit të miratuar.
- d) Grupet e punës përbëhen nga personel akademik, jo-akademik dhe studentë të UV-së. Çdo grup pune, përveç personelit akademik, duhet të ketë në përbërje edhe personel ndihmës-akademik dhe administrativ, në funksion të përmbushjes së gjithë procedurave dhe raportimeve të projektit. Grupi i punës duhet të përfshijë edhe studentë të të gjitha cikleve të studimit, së paku për procesin e zbatimit dhe mbledhjes së të dhënave.
- e) Drejtuesi i projektit është përgjegjës për përgatitjen dhe dorëzimin e dokumentacionit të aplikimit sipas formatit të miratuar, për raportimet periodike gjatë zbatimit dhe për raportin përfundimtar shkencor e financiar të projektit.
- f) Ai aplikon dhe bën pjesë të dosjes së aplikimit:
 - 1. Lejen Etike, të miratuar nga Komiteti i Etikës në Kërkim (kur projekti përfshin studentë apo personel të UV-së);
 - 2. Miratimin paraprak nga njësia bazë ose QKSH në të cilën bënë pjesë;
- g) Ai garanton përdorimin korrekt të fondeve të projektuara, pa ndërhyrë në procedurat financiare, dhe raporton te KSHF çdo ndryshim të parashikuar në planin e punës apo në grupin kërkimor.
- h) Ai mban përgjegjësi për cilësinë dhe integritetin e rezultateve shkencore, për publikimin e tyre në revista dhe konferenca të njohura, si dhe për depozitimin e të dhënave kërkimore në Data Repository UniVlora, sipas kërkesave të Rregullores së UV-së.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

KREU III

THIRRJA, APLIKIMI, VLERËSIMI DHE MIRATIMI I PROJEKTEVE KËRKIMORE-
ZHVILLIMORE (PKZH)

Neni 5

Hartimi dhe publikimi i thirrjes

1. Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Projekteve (SKSHP) brenda 5 ditëve pas miratimit nga Bordi i Administrimit të fondit vjetor për projektet PKZHUV, harton Thirrjen për Aplikim (*shtojca 1*), në përputhje me prioritetet institucionale dhe standardet e kërkimit, dhe e përcjell nëpërmjet Zëvendësrektorit të Kërkimit Shkencor për miratim përfundimtar në Rektorat.
2. Pas miratimit në Rektorat, SKSHP:
 - a) publikon thirrjen në faqen zyrtare të UV-së;
 - b) e shpërndan përmes adresave zyrtare të email-it tek i gjithë stafi akademik, drejtuesit e njësive dhe qendrat kërkimore;
 - c) arkivon kopjen elektronike të thirrjes dhe email si provë e njoftimit zyrtar.
3. Thirrja përmban:
 - a) fushat prioritare;
 - b) qëllimin dhe objektivat e thirrjes;
 - c) kriteret e pranueshmërisë së aplikantëve;
 - d) buxhetin në dispozicion
 - e) afatet e aplikimit, vlerësimit dhe raportimit;
 - f) dokumentet shoqëruese të detyrueshme.
 - g) mënyrën e dorëzimit të aplikimit;
 - h) kriteret e vlerësimit dhe rolet e Komitetit Shkencor (KSHF) dhe të Etikës (KEK).
 - i) formatet e aplikimit (*sipas formularëve të përditësuar të AKKSHI-t*).
4. Kohëzgjatja e projekteve PKZHUV mund të jetë nga 4 muaj deri në 6 muaj, sipas natyrës dhe objektivave të tyre.
5. Projektet mund të planifikohen me faza për disa vjet me rradhë dhe të kërkojnë financime të përsëritura për çdo vit. Çdo fazë aplikohet, financohet dhe çertifikohet brenda një viti buxhetor.

Neni 6

Kategoritë e shpenzimeve të lejuara dhe kufijtë buxhetorë

1. Fondet e miratuara nga Bordi i Administrimit për PKZHUV përdoren vetëm për shpenzime të lidhura drejtpërdrejt me qëllimet kërkimore të projektit.
2. Shpenzimet e lejuara janë:
 - a) Publikime shkencore në revista ndërkombëtare të huaja në vendet e BE-së, OECD ose G-20, të indeksuara në *Journal Citation Reports (JCR)* dhe/ose *SCOPUS*;
 - b) Materiale kërkimore, instrumente laboratorike, komponentë elektronikë, softëare analitikë ose mjete që mbështesin drejtpërdrejt aktivitetin kërkimor;
 - c) Kosto lëvizjeje dhe udhëtimi (transport, akomodim dhe dieta) për qëllime kërkimore, prezantimi rezultatash, pjesëmarrje në konferenca ose mbledhje të dhënash;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

- d) Materiale kancelarie dhe promovuese, përfshirë letra printeri, bojë, blloqe pune, fletëpalosje, shtypje postera dhe materiale prezantimi të projektit;
- e) Shpenzime katering për aktivitete/ ëorkshop/ konferenca/ seminare
- f) Paga dhe honorare për stafin akademik, jo-akademik ose studentor të përfshirë në projekt, për detyra të përcaktuara në planin e punës dhe të kontraktuara sipas rregullave të UV-së.
3. Përdorimi i buxhetit mund të bëhet për çdo kategori të mësipërme, duke respektuar planin financiar të miratuar dhe rregullat e zbatimit buxhetor të UV-së.
4. Çdo shpenzim duhet të dokumentohet me dokumentacion financiar zyrtar në emër të Universitetit dhe të përfshihet në raportin financiar të projektit.
5. Shpenzime jashtë këtyre kategorive, ose pa dokumente justifikuese, konsiderohen të palejueshme dhe nuk rimbursohen.

Neni 7

Aplikimi dhe dorëzimi i dosjeve

1. Pas publikimit të thirrjes, drejtuesi dhe grupi i punës (me përbërje me shumicë nga njësia ku bën pjesë drejtuesi i grupit) përgatisin projekt-propozimin në përputhje me termet e thirrjes së publikuar.
2. Drejtuesi i projekt-propozimit kërkon leje etike për zhvillimin e projektit të propozuar me rrugë shkresore,
 - tek KEK – kur projektet planifikohet të zhvillohen brenda infrastrukturës dhe popullatës studentore / personelit të UV-së
 - tek strukturat përgjegjëse – kur projekti planifikohet të zhvillohet jashtë strukturave të UV-së.
3. Drejtuesi i projekt-propozimit sigurohet të dorëzojë dosjen e plotë të aplikimit pranë SKSHP brenda afatit të përcaktuar në thirrje (zakonisht brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së saj),
 - a) në format elektronik, përmes adresës zyrtare të SKSHP-së;
 - b) shkresërisht, përmes protokollit të njësisë kryesore, duke respektuar linjën hierarkike të komunikimit shkresor institucional.
4. Dosja duhet të përmbajë:
 - a) miratimin paraprak të njësisë bazë / QKSH-së, të skanuar;
 - b) lejen Etike, të skanuar (nëse kërkohet);
 - c) formatin në ëord të projekt propozimit, përfshirë kalendarin e aktiviteteve; (shtojca 2);
 - d) formatin në excel të buxhetit të propozuar. (shtojca 3)
5. Pas përfundimit të afatit të dorëzimit, SKSHP brenda 5 ditëve kryen verifikimin formal të dosjeve, për të siguruar nëse përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar, të plotësuar sipas kërkesave të kësaj procedure dhe të thirrjes së miratuar.
6. SKSHP njofton elektronikisht përmes adresës zyrtare drejtuesin e projekt-propozimit që nuk ka dokumentacion të plotë, ka pasaktësi në plotësim, apo që nuk përmbushin kriteret dhe formatin standard të përcaktuar. Plotësimet dhe korrigjimet e nevojshme bëhen brenda 2 ditëve nga data e njoftimit. Vetëm dosjet e plota procedohen për vlerësim nga Komiteti Shkencor i Fakulteteve.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Neni 8

Vlerësimi dhe miratimi shkencor

1. Dosjet e verifikuara i përcillen elektronikisht (kopje e skanuar) KSHF/KSHI për vlerësim.
2. KSHF/KSHI, brenda afatit prej dhjetë (10) ditësh nga përfundimi i aplikimit, kryejnë vlerësimin e çdo projekt-aplikimi përmes skedës së vlerësimit të miratuar në *Shtojcën 4* të kësaj rregulloreje, e cila është në përputhje me formatet standarte të miratuara nga AKKSHI për projektet kombëtare, si dhe me praktikën e projekteve ndërkombëtare. Për çdo projekt aplikimi të vlerësuar, anëtarët e Komisionit janë të detyruar të nënshkruajnë Deklaratën e Konfliktit të Interesit, Paanshmërisë dhe Integritetit Profesional.
3. Në rast të pamundësisë së marrjes së një vendimi, KSHF ia adreson vendimmarrjen KSHI. Pamundësia e marrjes së vendimit mund të ndodhë në rastet kur shumica e anëtarëve të KSHF kanë konflikt interesi me projektin e aplikuar, apo kur vendimi është pa shumicë votash.
4. KSHF/KSHI miratojnë projekt-propozimet fituese dhe ua bëjnë me dije vendimin e arsyetuar kandidatëve aplikantë.
5. Procedura e apelimit
 - a) Aplikanti ka të drejtë të paraqesë ankesë të arsyetuar brenda 3 ditëve pune nga njoftimi i vendimit.
 - b) Ankesa shqyrtohet nga Komiteti Shkencor Institucional *ad hoc*, përbërja e të cilit bazohet gjerësisht në profesorat nga fusha e studimit të projektit.
 - c) Në rast të ankimimit të një aplikimi në nivel institucional, Rektori ngre një komitet të dytë KSHI *ad hoc*, që shqyrton ankimimin mbi vendimmarrjen e të parit.
 - d) Vendimi mbi ankesën merret brenda 5 ditëve pune dhe është përfundimtar në nivel institucional.
6. KSHF/KSHI përcjellin për miratim përfundimtar pranë Rektoratit listën e projekteve të lejuara për zhvillim, mbështetur në buxhetin në dispozicion për çdo njësi/QKSH.
7. Rektorati merr vendimin e miratimit përfundimtar të PKZHUV në bazë të relacionit të SKSHP, që përfshin verifikimin e zbatimit të procedurës së kërkuar nga Kreu III i kësaj Rregulloreje:
 - a) miratimin e njësisë bazë
 - b) lejen etike nga KEK (nëse kërkohet)
 - c) projekt-propozimin
 - d) projekt-buxhetin
 - e) lejen zhvillimore nga KSHF
8. Ky vendim i bëhet me dije drejtuesit të projekt-propozimit, njësisë bazë/QKSH, KSHF, SKSHP dhe Sektorit ekonomik.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

**KREU IV
ZHVILLIMI DHE MONITORIMI I PKZHUV**

**Neni 9
Zbatimi i Projektit**

1. Drejtuesi i projektit (koordinatori) është përgjegjës për realizimin e të gjitha aktiviteteve kërkimore dhe menaxheriale, në përputhje me planin e punës dhe buxhetin e miratuar. Ai siguron që:
 - a) aktivitetet të zhvillohen sipas afateve të përcaktuara në kontratë;
 - b) shpenzimet të kryhen vetëm për qëllimet e projektit dhe brenda zërave të miratuar;
 - c) çdo aktivitet të ketë dokumente provuese (raporte, foto, procesverbale, fatura, listë-prezence, etj.);
 - d) çdo rezultat (artikull, raport, produkt kërkimor) të mbajë logon dhe citimin "*Projekt i financiar nga Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë (PKZHUV)*".
2. Në çdo fazë, por jo më vonë se 30 ditë para datës së mbylljes së projektit, mund të kërkohej modifikim i buxhetit ose planit të punës, por vetëm me miratim paraprak të KSHF dhe miratim përfundimtar të Rektoratit. Ky vendim i bëhet me dije drejtuesit të projektit, njësisë bazë/QKSH, KSHF, SKSHP dhe sektorit ekonomik dhe bëhet pjesë e dosjes së projektit.
3. Ndryshimet lejohen vetëm kur:
 - a) nuk çenojnë qëllimin dhe objektivat e projektit;
 - b) nuk ndryshojnë totalin e buxhetit të miratuar;
 - c) justifikohen me arsye teknike ose administrative.
4. Rishpërndarjet e brendshme të buxhetit lejohen deri në $\pm 10\%$ të vlerës së një zëri, me miratimin e KSHF dhe Rektoratit.
5. Administratori zbaton disbursimet e zërave jo-paga, sipas kërkesës së drejtuesit të projektit gjatë kohës së zhvillimit të tij. Pagat e grupit të punës kalojnë pas dorëzimit të raportit shkencor përfundimtar dhe miratimit të tij në Rektorat.
6. Sektori Ekonomik kontrollon përputhshmërinë e çdo shpenzimi me buxhetin e miratuar dhe ruan dokumentet për auditim.

**Neni 10
Raportimi dhe Mbyllja e Projektit**

1. Brenda datës 15 Nëntor të vitit buxhetor të fitimit të projektit, Drejtuesi i projektit dorëzon pranë SKSHP në rrugë elektronike dhe shkresore:
 - a) Raportin Përfundimtar, sipas formatit të miratuar sipas llojit të projektit (shkencor/aplikativ) (shtojca 5);
 - b) Raportin Përfundimtar Financiar, të firmosur nga drejtuesi i projektit dhe të verifikuar paraprakisht nga Sektori Ekonomik (shtojca 6). Në këtë fazë duhet të bashkëngjiten edhe time sheet-et, të cilat pasqyrojnë punën e realizuar nga secili anëtar i grupit të punës (shtojca 7). Time sheet-et duhet të jenë të nënshkruara nga drejtuesi i projektit dhe nga çdo anëtar i përfshirë në projekt.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- c) Minimalisht një artikull origjinal për botim në revistat shkencore të UV-së (nëse projektet janë të tipit: kërkim shkencor).
2. SKSHP brenda 10 ditëve:
 - a) verifikon plotësimin formal të raportit (nëse përmban formatin/et, nënshkrimet dhe dokumentet);
 - b) kontrollon përputhshmërinë e shpenzimeve me buxhetin e miratuar dhe kategoritë e lejuara;
 - c) nëse mungojnë dokumente ose formate të kërkuara, SKSHP kërkon korrigjimin e raportit brenda 3 ditëve pune përpara se ta përcjellë tek KSHF.
 - d) përcjell raportet e plota tek KSHF për vlerësim shkencor përfundimtar.
3. KSHF, në cilësinë e organit përgjegjës për monitorimin shkencor dhe akademik të ecursisë së projektit, brenda 5 ditëve nga marrja e dokumenteve:
 - a) shqyrton raportin përfundimtar mbi përmbajtjen shkencore, cilësinë e rezultateve dhe arsyetimin e shpenzimeve;
 - b) verifikon përputhjen e aktiviteteve me objektivat shkencorë dhe cilësinë e rezultateve të arritura;
 - c) verifikon përfshirjen e studentëve dhe grupit të punës;
 - d) mund të kërkojë sqarime shtesë nga drejtuesi i projektit;
 - e) miraton me vendim të protokolluar (*shtojca 8*):
 - A. certifikimin e mbylljes së projektit (nëse rezultatet janë realizuar $\geq 80\%$ dhe shpenzimet janë të justifikuara);
 - B. vërejtje / masa korrigjuese, në rast vonesash ose mospërputhjes;
 - C. mos-certifikim të mbylljes së projektit, në raste të shkeljeve të rëndësishme ose mungesës së raportimit.
4. Vendimi i KSHF i përcillet Rektoratit për vendimarrje përfundimtare.
5. Rektorati merr vendimarrje pozitive për përmbylljen e PKZHUV në bazë të relacionit të SKSHP (brenda 10 ditëve), i cili përmban vlerësimin e zbatimit të procedurës:
 - a) vendimin e miratimit të PKZHUV nga Rektorati
 - b) raportin përfundimtar (studim/analitik), shkencor dhe financiar të projektit
 - c) vendimin e KSHF
 - d) artikullin origjinal për botim në revistat shkencore të UV-së dhe/ose revista shkencore të tjera (nëse projektet janë të tipit: kërkim shkencor).
6. Rektori, bazuar në vendimin e rektoratit, nxjerr Urdhër për mbylljen përfundimtare të projektit, i cili:
 - a) konfirmon realizimin e objektivave shkencore;
 - b) autorizon mbylljen e bilancit financiar pranë Administratorit;
 - c) përcakton nivelin e realizimit (përqindjen e realizit teknik dhe financiar)
6. Administratori dhe Sektori Ekonomik:
 - a) kontrollojnë përfundimisht dosjen financiare;
 - b) mbyllin kontabilitetin e projektit dhe pasqyrojnë shpenzimet në bilancin e UV-së;
 - c) përgatisin një tabelë përmbledhëse vjetore të projekteve PKZHUV për raportim në Bordin e Administrimit.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

7. Sektori i Kërkimit Shkencor & Projekteve përditëson databasën e PKZHUV në faqen zyrtare të UV-së.

Neni 11

Publikimi, Arkivimi dhe Raportimi institucional

1. SKSHP, pas mbylljes përfundimtare, arkivon dosjen teknike dhe financiare të projektit në formë fizike dhe elektronike për një periudhë jo më pak se 5 vjet.
2. Të dhënat kryesore të projektit regjistrohen në Databazën e Projekteve Kërkimore të UV-së, me statusin "mbyllur".
3. Rezultatet publikohen në:
 - a) Faqen zyrtare të UV-së;
 - b) Buletinin Shkencor të UV-së dhe UniVlora Scientific Journal;
 - c) Data Repository UniVlora;
 - d) Revista shkencore jashtë UV-së
4. SKSHP përgatit çdo fundviti Raportin Përmbledhës Institucional të Kërkimit Shkencor, që përfshin:
 - a) listën e projekteve të përfunduara;
 - b) rezultatet shkencore dhe produktet e krijuara;
 - c) analizën e buxheteve të shpenzuara;
 - d) rekomandimet për ciklin e ardhshëm të thirrjeve.

KREU V

Dispozita të fundit

Neni 12

Afatet dhe hyrja në fuqi

1. Projektet kanë kohëzgjatje nga 4 deri në 6 muaj. Ato mund të planifikohen me faza për disa vjet me rradhë dhe të kërkojnë financime për çdo vit.
2. Formulari dhe udhëzimet e aplikimit përditësohen çdo vit nga Sektori i Projekteve, sipas ndryshimeve të publikuara nga AKKSHI.
3. Shtojcat 1; 2; 3; 4; 5; 6; 7 dhe 8 janë pjesë integrale e këtij vendimi dhe përditësohen automatikisht sipas modelve të publikuara çdo vit prej AKKSHI-t për thirrje PKKZH.
4. Kjo procedurë hyn në fuqi pas miratimit nga Senati Akademik dhe zëvendëson çdo version të mëparshëm të procedurës për mini-projektet apo projektet PKZHUV me financim nga buxheti UV-së.

KRYETARE E SENATIT AKADEMIK

Prof.Dr. AURELA SALIAJ

